




Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

# NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE TË MBETURA PRITET TË PËRFUNDOJË KËTË JAVË



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se numërimi i fletëvotimeve të mbetura nga votimi jashtë Kosovës, i fletëvotimeve me kusht dhe i atyre të personave me nevoja të veçanta, pritët të përfundojë gjatë kësaj jave. Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, ka thënë se nëse nuk do të ketë ankesa, KQZ-ja do të vazhdojë me shpalljen e rezultateve përfundimtare

**ÇËSHTJA E PRESIDENTIT, KURTI: EKZISTON MUNDËSIA JO VETËM TEORIKE, POR EDHE PRAKTIKE QË TË SHKOJMË SËRISH NË ZGJEDHJE** F. 6



**KRU 'PRISHTINA' PUBLIKON TARIKAT E REJA TË UJIT PËR VITET 2026-2028, RITJE DERI NË 40 PËR QIND** F. 7



**TRUMPI PARALAJMËRON UDHËHEQËSIT VENEZUELAS SE DO TË PAGUAJNË "ÇMIM TË MADH" NËSE NUK BASHKËPUNOJNË** F. 2

**ZBATIMI I MARRËVESHJES EKZISTUESE ME SERBINË, NË LISTËN E DËSHIRAVE TË HAGREAVES PËR 2026-n** F. 3

**KUR TË QARAT E TË VEGJËLVE PËRPLASEN ME MURET E QKUK-SË** F. 5

## EKONOMI



**LUKSEMBURGU NDAN MBI NJË MILION EURO PËR IDE INOVATIVE NË KOSOVË** F. 8

**RITJA E VAZHDESHME E ÇMIMEVE, KËRKOHET NGA QEVERIA T'I VËZHGOJË BIZNESET** F. 8

## SPORT



**KOMBËTARJA E KOSOVËS NË HENDBOLL LUAN DY MIQËSORE NË SLOVENI** F. 24

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princsha-ks.com

**Buniamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjbiznesi.com  
info@kolegjbiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# TRUMPI PARALAJMËRON UDHËHEQËSIT VENEZUELAS SE DO TË PAGUAJNË ‘ÇMIM TË MADH’ NËSE NUK BASHKËPUNOJNË

UASHINGTON, 5 JANAR - Me udhëheqësin e rrëzuar të Venezuelës, Nicolas Maduron, tashmë në një burg amerikan, presidenti amerikan Donald Trump paralajmëroi udhëheqësit autoritarë të vendit të Amerikës së Jugut se do ta “pagojnë një çmim shumë të madh” nëse nuk “bashkëpunojnë” me Uashingtonin, edhe mes shqetësimeve globale për sulmin ushtarak amerikan. Trumpi, në një intervistë të publikuar më 4 janar në “The Atlantic”, paralajmëroi presidenten në detyrë të Venezuelës, Delcy Rodriguez, se “nëse ajo nuk bën atë që është e drejtë, do të paguajë një çmim shumë të madh, ndoshta më të madh se Maduro”.

Rodriguez, e krahut të majtë politik, ishte zëvendëspresidente e Maduros përpara se të emërohej presidente në detyrë më 4 janar. Ajo e quajti veprimin e ShBA-së shkelje të Kartës së OKB-së dhe u zotua se “ne nuk do të jemi kurrë më sklevër”.

Maduro më 4 janar ndodhej në një burg amerikan pasi ishte transportuar në Nju-Jork pas kapjes së tij nga forcat amerikane gjatë sulmit që u dënua nga Irani, Rusia dhe aleatë të tjerë të vendit të Amerikës së Jugut, por u përshëndet nga venezuelianët që jetojnë në mërgim.

Një video e postuar nga “Fox News” në rrjetet sociale tregonte Maduron, 63 vjeç, duke u shoqëruar nga agjentë federalë dhe duke u thënë gazetarëve: “Natën e mirë, Gëzuar Vitin e Ri!”. Ai dhe bashkëshortja e tij - e cila gjithashtu u kap gjatë bastisjes - planifikohet të paraqiten në gjykatë më 5 janar për t’u përballur me akuza për drogë.

Në një konferencë shtypi, Trump e përshëndeti operacionin ushtarak në Venezuelë, por nuk dha hollësi. Një gjeneral i lartë amerikan tha se 150 avionë amerikanë ishin përfshirë në

sulm pas muajsh përgatitjesh.

Shifrat e viktimave nuk u zbuluan. Trumpi tha se disa zyrtarë amerikanë u plagosën, por shtoi se ata janë mirë. Ndërkohë, Kuba tha se 32 anëtarë të forcave të saj të sigurisë u vranë në Venezuelë gjatë sulmit amerikan.

Trumpi shkaktoi reagime kur tha se Shtetet e Bashkuara do ta “drejtojnë” përkohësisht vendin e Amerikës së Jugut “derisa të vijë momenti kur të mund të bëjmë një tranzicion të sigurt, të duhur dhe të matur”.

Nuk ishte menjëherë e qartë se çfarë nënkuptonte Trumpi me atë që ShBA-ja do ta “drejtojë” vendin. Ai u tha gazetarëve se po “caktonte njerëz” nga kabineti i tij për të qenë përgjegjës në Venezuelë, pa dhënë hollësi shtesë.

Zyrtarë të administratës amerikane - përfshirë sekretarin e Shtetit, Marco Rubio - nuk dhanë sqarime kur u pyetën gjatë emisioneve televizive më 4 janar për planin e Trumpit.

## Rodriguezi sinjalizon gatishmëri për pajtim

Gjykata e Lartë e Venezuelës urdhëroi që Rodriguez ta merrte rolin e presidentes në detyrë të qeverisë së majtë.

Trumpi fillimisht shprehu mbështetje për Rodriguezin, duke thënë se “ajo në thelb është e gatshme të bëjë atë që ne mendojmë se është e nevojshme për ta bërë Venezuelën sërish të madhe”.

Rodriguez, e cila mbështetet nga ushtria venezueliane - fillimisht u shfaq sfiduese, duke e quajtur Maduron “presidentin e vetëm” të vendit dhe duke e cilësuar sulmin amerikan si një “njollë të tmerrshme” në marrëdhënie.

Pasi Trumpi sinjalizoi se ishte gati të kryente një valë të dytë veprimesh ushtarake në Venezuelë nëse do të ishte e



nevojshme, Rodriguez zbuloi qëndrimin e saj, duke shkruar në rrjetet sociale herët më 5 janar se Karakasi kërkonte një marrëdhënie “të balancuar dhe të respektueshme” me Uashingtonin.

“Ne i shtrijmë një ftesë qeverisë amerikane për të punuar së bashku në një agjendë bashkëpunimi që synon zhvillimin e përbashkët”, shkroi ajo.

Sulmet amerikane në Venezuelë dhe kapja e Maduros u dënuan ashpër nga disa aleatë të Karakasit, si dhe nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, i cili tha se veprimi ushtarak amerikan vendos një “precedent të rrezikshëm”.

Agjencitë e lajmeve cituan burime që thanë se Këshilli i Sigurimit i OKB-së do të mbledhet në orën 10:00 të mëngjesit më 5 janar për të diskutuar operacionin amerikan. Kolumbia, e mbështetur nga Rusia dhe Kina, kërkoi seancën, thanë diplomatët.

## Reagimi i diasporës venezueliane

Për Jesus Guarecucon, një mjek venezuelian në fund të të tridhjetave që jeton në Miami, Florida, lajmi solli një ndjenjë lehtësimi të shumëpritur. “Ne jemi absolutisht të lumtur për atë që ndodhi. Kjo është diçka që e kemi pritur për caq shumë kohë”, i tha Guarecuco “Radios Evropa e Lirë”.

Guarecuco tha se shumë venezuelianë ndihen sikur nuk janë dëgjuar pavarësisht viteve të tëra thirrjesh drejtuar komunitetit ndërkombëtar, përfshirë Kombet e Bashkuara. Guarecuco jeton në Shtetet e Bashkuara që nga viti 2018 pasi u largua nga Venezuela dhe kërkoi azil politik, për të cilin tha se erdhi si pasojë e përndjekjes së lidhur me aktivitetin e tij politik opozitar. Ai tha se zhvillimet janë pritur me një përzierje lehtësimi dhe pasigurie mes venezuelianëve.

“Shumë venezuelianë janë të hutuar për atë që do të ndodhë më pas. Mendoj se kjo është si një lojë shahu. Duhet të bëhen shumë lëvizje politike”, tha ai, duke shprehur shpresën se ky veprim do të çojë drejt një qeverie tranzitore dhe, përfundimisht, drejt vendosjes në pushtet të kandidatit opozitar Edmundo Gonzalez. “Ne e dimë që do të marrë kohë, por kjo është ajo që po presim”, tha ai. Ai shtoi se çdo përfshirje amerikane ka të ngjarë të shoqërohet me marrëveshje të reja, veçanërisht lidhur me naftën, nga të cilat, sipas tij, mund të përfitojnë të dy ekonomitë. “Nëse i pyet njerëzit e zakonshëm, atyre në të vërtetë nuk u intereson nafta”, tha ai. “Ajo që duan është largimi i Maduros, bashkë me rrethin e tij të ngushtë. Ata duan një qeveri të re, një Venezuelë të re ku njerëzit mund të punojnë, të kenë mundësi dhe një vend të ri. Kjo është ajo që po presim”, tha Guarecuco.

## Pse Vuçiqi nuk po i shpall zgjedhjet e parakohshme?

BEOGRAD, 5 JANAR - Edhe pse deri së fundmi ishte praktikë e rregullt, tani pushteti në Serbi i sheh zgjedhjet e parakohshme parlamentare si diçka që i përket së ardhmes.

Ndoshta në pranverë, ndoshta vetëm pas një viti.

Kështu u përgjigj presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nga Partia Përparimtare Serbe (SNS) në pushtet, ndaj kërkesës së studentëve protestues.

Politologu Dejan Bursaç thotë për Radion Evropa e Lirë se ekziston një problem nëse SNS-ja, të cilën ai e quan “makineri zgjedhore”, nuk shkon në zgjedhje të parakohshme edhe pse më parë e ka bërë këtë vazhdimisht.

“Ky problem quhet: nuk mund t’i fitojnë zgjedhjet”, vlerëson Bursaç, bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin për Filozofi dhe Teori Shoqërore.

“Pra, zgjedhjet për ta janë një

vilajet i madh i errët”, shtoi ai.

Studentët protestues njoftuan më 29 dhjetor se gati 400 000 qytetarë kanë mbështetur kërkesën e tyre për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Serbi. Megjithatë, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, shprehu dyshime për këtë shifër, duke vlerësuar se ata nuk kanë mbledhur “as shtatë për qind” të saj.





## Zbatimi i marrëveshjes ekzistuese me Serbinë, në listën e dëshirave të Hagreaves për 2026-n

PRISHTINË, 5 JANAR - Ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hagreaves, ka shprehur dëshirat e tij për vitin 2026 në lidhje me Kosovën. Një ndër to ishte edhe marrja e iniciativës për dialogun, ku u shpreh se do të donte që politikanët e Kosovës të premtojnë se do të bëjnë gjithçka që munden për zbatimin e marrëveshjes ekzistuese me Serbinë.

Ai tha se qeveria e re duhet të ketë guxim dhe mençuri politike për ta marrë iniciativën dhe, siç u shpreh, për të punuar nën lehtësimin e BE-së për të sjellë paqe të qëndrueshme me fqinjin e saj. “Ne do vazhdojmë t’i bëjmë thirrje Serbisë që ta bëjë të njëjtën gjë. Në vitin 2025 Mbretëria e Bashkuar konfirmoi angazhimin e saj në KFOR për të paktën deri në

dhjetor 2028, duke vazhduar të vërë ushtarët e saj në shërbim të sigurisë së këtij rajoni. Por siguria e vërtetë - ajo lloj sigurie që një ditë do t’ua mundësojë ushtarëve tanë të kthehen në shtëpi, qëndron në një marrëdhënie të normalizuar dhe të qëndrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë”, ka shkruar Hagreaves në rrjetet sociale.



## ÇËSHTJA E PRESIDENTIT, KURTI: EKZISTON MUNDËSIA JO VETËM TEORIKE, POR EDHE PRAKTIKE QË TË SHKOJMË SËRISH NË ZGJEDHJE

PRISHTINË, 5 JANAR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se ekziston mundësia jo vetëm teorike, por edhe praktike që Kosova të shkojë prapë në zgjedhje, në rast se nuk arrijnë ta zgjedhin presidentin e ri. Katër muaj para se t’i skadojë mandati presidentes aktuale, Vjosa Osmani, Kurti është më i matur nëse e përkrahin Osmanin edhe për një mandat tjetër pesëvjeçar. Sipas tij, një test dhe indikacion se si mund të ecet përpara edhe në çështjen e presidentit është miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për të cilat nevojitet mbështetje edhe e deputetëve të opozitës. Kurti në një intervistë për “KosovaPress” ka thënë se fillimisht duhet konstituimi i Kuvendit, formimi i qeverisë, miratimi i buxhetit dhe pastaj të mendohet për çështjen e zgjedhjes së presidentit. “Nëse nuk arrijmë ta zgjedhim presidentin, ose ta rizgjedhim presidenten, e afati i fundit për këtë gjë është 4 marsi, nëse nuk e kemi të kaluar paraprakisht buxhetin për vitin 2026, ne as nuk mund të mbajmë zgjedhje të reja. Se natyrisht ekziston mundësia, jo vetëm teorike,



por edhe praktike, që ne të shkojmë prapë në zgjedhje, në rast se nuk arrijmë ta rizgjedhim presidenten. Por në një situatë të tillë duhet të jemi të gatshëm, pikërisht duke e pasur buxhetin e votuar. Prandaj unë po them, nuk

është e shëndetshme të flasim për hapin e katërt pa i trajtuar mirë dhe kaluar këta tre të parët”, është shprehur ai. Kurti, i cili është edhe lider i LV-së, parti e cila sipas rezultateve preliminare të KQZ-së ka mbi 50 për qind të votave në

zgjedhjet e 28 dhjetorit, e konsideron të nevojshëm takimin me Osmanin për të diskutuar interesimin e saj për një mandat tjetër në krye të vendit. Sipas tij, sigurimi i 80 deputetëve në sallë në momentin e zgjedhjes së presidentit është një vështirësi e konsiderueshme. “Tash ne e kemi parë deklarinimin e presidentes. Së pari duhet ta formojmë Kuvendin dhe qeverinë. Gjithashtu duhet ta votojmë buxhetin. Unë besoj që këta janë hapat më të rëndësishëm. Pra, janë tre hapa para se të vijmë te rizgjedhja e presidentes. Dhe unë besoj që nga këta tre hapa ne do t’i shohim se si janë gjasat përpara. Unë kam deklaruar që është e rëndësishme të ulemi me presidenten dhe të diskutojmë të gjitha gjërat. Nevojitet ky takim për shkak se 80 veta në sallë është vështirësi e konsiderueshme. Ju po e keni parasysh që herën e kaluar s’i bëmë dot 61. 80 është numër shumë më i madh se 61. Dhe përderisa kësaj radhe ne i kemi 61, 80 vota nuk i kemi. Dhe këto marrëveshje ndërkombëtare, të cilat po përpiqemi t’i kalojmë sa më shpejt, unë besoj që do të

mund të na japin indikacione për rrugën përpara. Por nuk besoj që është e drejtë, as e dobishme, që të flasim për hapin e katërt pa i parë këta tre të parët”, ka deklaruar ai. Duke folur për mundësitë që partitë e opozitës, veçanërisht LDK-ja, të qëndrojnë në sallën plenare kur votohet presidenti, Kurti tha se nuk e di se çfarë qëndrimesh do të mbajnë partitë e opozitës në javët dhe muajt në vijim. “Për besë nuk e di. Ky viti 2025, me një qasje bllokuese e barrikaduese të partive opozitare, më ka çuditur edhe mua. Po të më thoshte dikush para një viti që viti 2025 do të ishte ashtu siç u bë, mund të dukej me shumë pak gjasa ose pa asnjë gjasë. Mirëpo ja që ndodhi. Prandaj unë nuk e di çfarë qëndrimesh do të mbajnë partitë opozitare në javët dhe muajt në vijim. A është e qartë që as marrëveshjet ndërkombëtare dhe as rizgjedhjen e presidentes, zgjedhjen e presidentit, ne nuk mund t’i kalojmë pa pasur edhe deputetë nga opozita. Ndërkohë që bllokadat sa i përket konstituimit të Kuvendit dhe formimit të qeverisë i ka larguar populli më 28 dhjetor”, ka theksuar Kurti.

## Festat e fundvitit me pasoja, rritet numri i lëndimeve nga mjetet piroteknike

PRISHTINË, 5 JANAR - Gjatë festave të fundvitit në Klinikën e Kirurgjisë Plastike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë trajtuar dhjetëra pacientë të lënduar si pasojë e përdorimit të mjeteve piroteknike, kryesisht petardave, ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës. Sipas njoftimit, pjesa më e madhe e të lënduarve janë fëmijë dhe adoleshentë, ndërsa lëndimet e trajtuara kanë qenë kryesisht në duar, veçanërisht në gishtërinj. Në disa raste këto lëndime kanë përfunduar me

amputime të pjesshme apo të plota, si dhe me dëmtime serioze funksionale të aparatit tendinoz. Po në Klinikën e Kirurgjisë Plastike janë regjistruar edhe lëndime në regjionin e fytyrës, të cilat kërkojnë trajtim të specializuar dhe mund të shkaktojnë pasoja estetike dhe funksionale afatgjatë. Aktualisht gjashtë pacientë janë të hospitalizuar në këtë klinikë për shkak të lëndimeve shumë të rënda të duarve të cilat kërkojnë mjekim të vazhdueshëm dhe

trajtim të specializuar. Nga ShSKUK-ja theksohet se lëndimet nga mjetet piroteknike shpesh shoqërohen me pasoja të përhershme funksionale dhe psikologjike si dhe kërkojnë ndërhyrje të shumta kirurgjikale dhe rehabilitim afatgjatë. Klinika e Kirurgjisë Plastike u ka bërë thirrje prindërve, kujdestarëve dhe institucioneve përkatëse që ta rrisin kontrollin dhe ndërgjegjësimin lidhur me rreziqet e përdorimit të mjeteve piroteknike, veçanërisht nga fëmijët.







# KUR TË QARAT E TË VEGJËLVE PËRPLASEN ME MURET E QKUK-së

PRISHTINË, 5 JANAR - Në derën e dhomës shkruan: “Njësia e fëmijëve pa përcjellje të nënave”. Kur afroresh dëgjon zërat apo frymëmarrjen e lehtë të dy foshnjave. Nuk janë thjesht thirrje për kujdes, por edhe jehonë e një të vërtete të hidhur. Në fillimdhjetorin e 2025-s, një sapo kishte mbushur një muaj jetë, tjetri tetëmbëdhjetë ditë. Të dy ishin braktisur nga nënat e tyre, ndërsa për baballarët nuk dihej. “Ne mundohemi t’i bindim nënat që të mos i lënë fëmijët, por në shumicën e rasteve vendimi është i prerë...”, thotë Yllka Shala, e cila udhëheq zyrën për fëmijët e braktisur në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).

## Histori pas secilit fëmijë

Yllka është personi i vetëm në këtë institucion që përpqet ta mbajë gjallë lidhjen midis nënës dhe fëmijës - edhe kur shanset janë kundër. Çdo ditë pune për të nis njësoj: me dosje të reja mbi tavolinë dhe me histori që rëndojnë më shumë se letrat që mban në duar. Në sytë e saj lexohet çdo ndarje që ka ndodhur në korridoret e repartit të Neonatologjisë. Ajo i njeh mirë hapat e nënave që hyjnë me kokën ulur, duart që dridhen kur firmosin

dokumentin e fundit dhe heshtjen e rëndë që mbetet pas tyre. “Secili rast është histori në vete, e të gjitha janë shumë të ndjeshme”, thotë ajo për “Radion Evropa e Lirë”. Yllka ulet përballë nënave jo si zyrtare, por si njeri. Flet ngadalë, me kujdes, duke kërkuar një fije të vogël shprese. U tregon për fëmijën, për fytyrën e tij, për ngjashmëritë që tashmë i sheh. “U them se dita kur një nënë ndahet nga fëmija i saj është një ditë e errët, sikur edhe dielli të mos ndriçojë më”, rrëfen ajo. Por, në shumicën e rasteve, fjalët nuk mjaftojnë. Vendimi është marrë shumë më herët - jashtë mureve spitalore. Një nga rastet që nuk e harron kurrë, ishte një nënë e re që nuk pushonte së qari. Qante para lindjes, qante pas lindjes, qante edhe kur e mbante foshnjën pranë. Ajo ngrihej për t’u larguar, ndalej, kthehej sërish. Një lëvizje e pafund mes dashurisë dhe frikës. “Ajo nuk ishte e ftohtë... ishte e tmerruar. Dhe në fund u largua vetëm”, kujton Yllka. Në shumicën e këtyre historive, një e përbashkët përsëritet pothuajse gjithmonë. Fëmijët që mbesin pas, duke qarë në dhomën e mbyllur të Neonatologjisë, janë kryesisht të lindur jashtë martese. Yllka thotë se pas tyre fshihen histori grash të shtyra drejt

cepit - pa përkrahje familjare, pa siguri ekonomike dhe të braktisura nga partnerët. Shumë nga to nuk japin asnjë detaj për identitetin e babait, ose zgjedhin të mos flasin fare për të. Pas momentit të braktisjes, historia e fëmijës nuk ndalet - ajo vetëm hyn në një fazë tjetër, po aq të pasigurt. Procedurat nisin menjëherë, në heshtje, larg syve të publikut. Në ditët e para pas lindjes, stafi i repartit njofton Qendrën për Punë Sociale në komunën nga vjen nëna, si dhe policinë. Dosja hapet, deklaratat merren dhe gjithçka dokumentohet. Foshnja, ndërkohë, mbetet në spital. Sipas rregullave, një fëmijë i braktisur mund të qëndrojë në spital deri në 40 ditë. Nëse gjendja shëndetësore nuk është e mirë, kjo periudhë mund të zgjatet edhe pak. Janë ditë pritjeje, ku çdo orë kalon njësoj: qumësht, gjumë, të qara dhe mungesë e një fytyre që do ta njihje si të vetën. Gjatë kësaj kohe, Yllka dhe stafi i Qendrës për Punë Sociale përpqen të mbajnë të hapur edhe një derë të fundit. Nëse nëna ndërron mendje, ligji i jep asaj ende të drejtë të kthehet dhe ta marrë fëmijën. Por kjo ndodh rrallë. Shumica e fëmijëve mbesin aty, në shtretër të vegjël, pa emra, vetëm me data lindjeje dhe numra dosjesh.

Kur kalojnë 40 ditët dhe shpresa për kthim shuhet, procedurat vazhdojnë drejt strehimit familjar. Qendrat për Punë Sociale marrin përsipër rastin dhe fëmija dërgohet në një familje strehuese.

## Shifra që flasin

Yllka thotë se vitet e fundit vërehet një rënie e lehtë e numrit të fëmijëve të braktisur. Jo sepse arsytet që i shtyjnë nënat drejt këtij vendimi janë zhdukur, por sepse numri i lindjeve ka rënë. Për krahasim, në vitin 2015 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë regjistruar 24 594 lindje, ndërsa 40 fëmijë janë braktisur. Një dekadë më vonë, në vitin 2024, numri i lindjeve ka rënë në 21.487, ndërsa numri i fëmijëve të braktisur në 23. Këtë vit, deri në mes të dhjetorit, në Klinikën e Gjinekologjisë - ku funksionon edhe reparti i Neonatologjisë - janë regjistruar gjithsej 32 raste të fëmijëve të braktisur. Yllka thotë se shifrat mund të mos tregojnë gjithë të vërtetën. Ajo thotë se ka raste kur nëna nuk do të flasë fare... ose edhe kur flet, është shumë e revoltuar. “Kam ardhur në QKUK për të lindur, sepse mund të kisha lindur në rrugë dhe askush të mos dinte për fëmijën tim”, shpjegon Yllka rastet me të cilat përballet.

## Dhoma e braktisjes

Teksa flet vëmendjen ia tërheqin zërat dhe lëvizjet e dy foshnjave në dhomën e dedikuar për ta. Historitë e tyre, edhe pse të ndryshme, ndajnë të njëjtin fund: u braktisën nga nëna që nuk panë rrugëdalje. Njëri ka lindur nga një nënë e re, vetëm 20 vjeçe, e pamundur të kujdeset për shkak të kushteve ekonomike dhe sociale. Tjetri, më i vogël dhe i dobët, ishte fëmijë i një gruaje 40-vjeçare, tashmë me dy fëmijë nën përkujdesjen e gjyshërve, ndërsa ajo ndodhej në burg. Për të tretin nuk kishte asnjë mundësi që ta siguronte kujdesin e duhur. Realiteti bëhet edhe më i vështirë nga kushtet në repartin ku qëndrojnë. Nga ora 7 deri në 14:00 për kujdesin e tyre përgjigjet vetëm një infermiere. Pas kësaj ore, dy infermiere të tjera marrin përsipër përgjegjësinë, duke u përkujdesur njëkohësisht edhe për 28 deri në 30 fëmijë të tjerë të repartit. Dhoma e fëmijëve të braktisur mbahet e mbyllur me dry kur nuk ka staf, për siguri. E, kjo do të thotë se të qarat e tyre shpesh mund të mbeten të padëguara, pa asnjë fytyrë që t’i qetësojë. Dhoma i ka katër shtretër të vegjël dhe Yllka lutet që ata të mbeten sa më bosh, me shpresën që çdo fëmijë të gjejë dashurinë dhe kujdesin që i nevojitet.



# NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE TË MBETURA PRITET TË PËRFUNDOJË KËTË JAVË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se numërimi i fletëvotimeve të mbetura nga votimi jashtë Kosovës, i fletëvotimeve me kusht dhe i atyre të personave me nevoja të veçanta, pritet të përfundojë gjatë kësaj jave. Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, ka thënë se nëse nuk do të ketë ankesa, KQZ-ja do të vazhdojë me shpalljen e rezultateve përfundimtare

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se numërimi i fletëvotimeve të mbetura nga votimi jashtë Kosovës, i fletëvotimeve me kusht dhe i atyre të personave me nevoja të veçanta, pritet të përfundojë gjatë kësaj jave. “Sipas të dhënave preliminare, nga 57 vendvotime ku është mundësuar votimi me kusht në 38 komuna, në përgjithësi janë evidentuar në sistem mbi 9 mijë e 900 votues të regjistruar për të votuar me kusht. Ndërkaq numri i votuesve të regjistruar në programin e votimit të personave me nevoja të veçanta ka qenë 2 860. Pra, po presim që sa më shpejt të shpallen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme të Kuvendit të Kosovës që janë mbajtur më 28 dhjetor”, ka thënë zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, duke shtuar se në kohën kur janë shpallur zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, KQZ-ja ka miratuar një plan të aktiviteteve për këtë proces zgjedhor dhe planifikimi i saj ka qenë që shpallja e rezultateve të bëhet më së largu më 19 janar.

“Brenda kësaj date parashihen edhe ankesat e mundshme dhe koha që iu duhet institucioneve si PZAP-së dhe Supremes për të vendosur për ankesat e mundshme. 19 janari është planifikuar duke marrë parasysh të gjitha këto aspekte për Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme. Në bazë të dinamikës së punëve, mund të arrijmë në një përfundim, që shpallja e rezultateve që ishte planifikuar të bëhet më 19 janar, të bëhet më herët”, ka sqaruar Elezi. Elezi ka treguar në konferencën për medie hapat që duhet të ndjekë KQZ deri në momentin e shpalljes së rezultateve. “Rruga që ndjek KQZ për shpalljen e rezultateve përfundimtare dhe më pas certifikimin e tyre përfshin disa hapa të rëndësishme. KQZ shpall rezultate përfundimtare vetëm pasi të përfundojnë këto procese: Verifikimi dhe numërimi i rezultateve në qendrat komunale që tashmë janë përmbyllur. Numërimi në QNR i fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, i fletëvotimeve nga votimi me kusht dhe fletëvotimeve nga votimi i personave me nevoja të veçanta, si dhe pasi të përfundojë shqyrtimi i ankesave të mundshme në PZAP dhe



Gjykatën Supreme për administrimin e numërimit”, tregoi Elezi. Ndërkohë që në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është duke vazhduar procesi i numërimit të fletëvotimeve që i takojnë votimit jashtë Kosovës, përkatësisht votimit përmes postës dhe së shpejti do të fillojë numërimi i fletëvotimeve që i takojnë votimit me kusht dhe fletëvotimeve nga votimi i personave me nevoja të veçanta. “Fletëvotimet e numëruara deri më tani janë nga më shumë se 28 mijë pakot me fletëvotime që ishin tërhequr, para vitit të ri, nga dy kutitë postare të KQZ-së, njëra në Berlin dhe tjetra në Bernë. Ndërkaq, më 2 janar, nga kutitë postare në Pragë, Londër, Paris, Zagreb, Stokholm, Stamboll, Nju-Jork, Kanbera dhe Kopenhagë, janë tërhequr 8 180 pako të tjera me fletëvotime, të cilat gjatë ditës do të arrijnë në Kosovë. Procesi i tërheqjes së pakove me

fletëvotime nga kutitë postare jashtë vendit është përmbyllur të hënën. Të gjitha këto, pasi të arrijnë në Kosovë, do t'i nënshtrohen vlerësimit/verifikimit dhe ato që do të aprovohen, do të përfshihen në numërim. Gjithashtu, gjatë ditës së sotme po planifikojmë dhe po bëjmë përpjekje që të fillojmë numërimin e fletëvotimeve që i takojnë votimit me kusht dhe fletëvotimeve nga votimi i personave me nevoja të veçanta. Sipas të dhënave preliminare, nga 57 vendvotime me kusht, në 38 komuna të vendit në përgjithësi janë evidentuar në sistem mbi 9 900 votues të regjistruar për të votuar me kusht, ndërkaq numri i votuesve të regjistruar në programin e votimit të personave me nevoja të veçanta ka qenë 2, 860”, ka theksuar Elezi. Sipas rezultateve preliminare të publikuara në uebfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje ka siguruar 50.50 për qind, ose 461

mijë e 698 vota. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) renditet e dyta me 20.49 për qind, përkatësisht 187 mijë e 328 vota, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë 13.37 për qind, apo 122 mijë e 254 vota. Ndërkaq, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka siguruar 5.55 për qind, ose 50 mijë e 776 vota, ndërsa Lista Serbe 4.60 për qind, përkatësisht 42 mijë e 17 vota. Bazuar në rezultatet preliminare, Lëvizja Vetëvendosje do të mund ta formojë qeverinë vetëm në bashkëpunim me komunitetet joshumicë. IV-ja ka siguruar 56 ulëse nga 100 sa u takojnë partive shqiptare, PDK-ja 23 ulëse, LDK-ja 15 ulëse, ndërsa AAK-ja 6 ulëse. Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare u mbajtën më 28 dhjetor për shkak të mosformimit të institucioneve të reja, gati një vit pas zgjedhjeve të rregullta, pasi subjektet politike nuk arritën pajtueshmëri për formimin e një koalicioni qeverisës.

## RAPORTI I KOSTT-it NGRE DYSHIME PËR MANIPULIM TË ÇMIMIT TË RRYMËS, PJESË E SKEMËS EDHE “ELEKTROPRIVEDA SRBIJE”

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Një raport i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, KOSTT, i cili është realizuar si pjesë e hetimeve të nisura në sektorin energjetik, ka ngritur dyshime për manipulim të çmimit të energjisë elektrike të importuar nga Kosova. Sipas raportit, i siguruar nga “Buletini Ekonomik”, kompanitë “Noa Energy Trade” dhe “Elektroprivreda Srbije” kanë bashkëpunuar në disa raste, duke qenë të vetmet që morën pjesë në ankandet për shitblerjen e linjave të transmisionit me destinacion Kosovën. Raporti sqaron se me kapacitetet e tyre në ankandet e SEECAO gjatë vitit 2025, këto dy kompani duket se kanë manipuluar sistemin për t'i rritur kostot e bartjes së energjisë elektrike për



Kosovën. Në vitin 2024 këto kosto arritën deri në 800 euro për megavat orë, ndërsa raporti i KOSTT-it për vitin 2025 mbulon periudhën janar-tetor dhe tregon se edhe gjatë këtij viti bartja e energjisë

ishte shumë herë më e shtrenjtë se çmimi i energjisë elektrike. Zyra e Ankandeve për Evropën Juglindore (SEECAO), me bazë në Podgoricë, është përgjegjëse për rregullimin e ankandeve për blerjen e kapaciteteve

ndërkufitare të transmisionit, ku pjesë e saj është edhe Kosova. Sipas raportit të KOSTT-it, në ankandet ditore dyshohet se kompanitë “Noa Energy Trade” dhe “Elektroprivreda Srbije” manipuluan tregun duke rritur kostot e bartjes, shpesh shumëfish më të larta se çmimi i energjisë. Të dhënat që KOSTT ka siguruar nga SEECAO tregojnë se ankandet me destinacion Kosovën kanë pasur tendenca për “bllokim të linjave” dhe përqendrim të lartë të ankandeve të vetëm këto dy kompani. Në të paktën 40 raste, tregu i ankandeve u përqendrua vetëm te “Noa Energy Trade” dhe “Elektroprivreda Srbije”. Ky raport ngre shqetësime për ndikimin e mundshëm të bashkëpunimit të këtyre

kompanive në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike për Kosovën dhe për pasojat që kjo ka pasur mbi konsumatorët dhe kostot e përgjithshme të sistemit energjetik. Ka dyshime dhe hetime që NOA Energy Trade, bashkë me kompaninë serbe (EFT), kanë përdorur strategji të koordinuara për t'i kontrolluar kapacitetet ndërkufitare në tregun energjetik, duke bllokuar ose monopolizuar rrugët e importit, që ndikon negativisht në konkurrencë dhe çmimet për Kosovën. Në muajin dhjetor kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar pretendimet për blerjen e energjisë elektrike nga kompania EFT e Vuk Hamoviçit. Ndërsa ka thënë se për NOA-n nuk di asgjë.



## Në rajonin e Mitrovicës konfiskohen armë dhe municione

**MITROVICË, 5 JANAR-** Në rajonin e Mitrovicës se Jugut gjatë tri ditëve të para të fillim vitit 2026 janë konfiskuar tri armë zjarri. Konfiskimi i armëve është

realizuar në lokacion të ndryshme në Mitrovicën e Jugut dhe Skenderaj. Armët e konfiskuara janë: dy pushkë gjuetie, një pistoletë dhe 159

fishkë të kalibrave të ndryshëm. Lidhur me armët e konfiskuara janë iniciuar raste penale për veprat: armëmbajtje pa leje,

përdorim i armës dhe kanosje. Nga këto raste, me vendim të prokurorit dy të dyshuarve u është caktuar masa e ndalimit policor.



# KRU ‘PRISHTINA’ PUBLIKON TARIFAT E REJA TË UJIT PËR VITET 2026-2028, RRRITJE DERI NË 40 PËR QIND

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” ka bërë publike tarifat e reja për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit për periudhën 2026-2028 të cilat kanë hyrë në fuqi që nga ky muaj. Sipas tarifave të reja, konsumatorët shtëpiakë do të paguajnë 0.63 euro për metër kub për shërbimet e ujësjellësit, çmim që paraqet një rritje rreth 40 për qind krahasuar me tarifat e mëparshme. Tarifa për shërbimet e ujërave të ndotura është caktuar 0.12 euro për metër kub, që përbën një rritje rreth 60 për qind. Për konsumatorët komercialë dhe institucionalë, tarifa e re për shërbimet e ujësjellësit është 0.82 euro për metër kub, nga 0.62 euro sa ishte më parë. Ndërsa për shërbimet e ujërave

të ndotura, tarifa është rritur në 0.28 euro për metër kub, krahasuar me 0.17 euro sipas tarifave të vjetra. KRU “Prishtina” ka sqaruar se tarifat janë përcaktuar nga Autoriteti Rregullativ për Ujërat (ARRU), në bazë të Ligjit nr. 05/L-042, me qëllim që të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të sigurojnë qëndrueshmëri financiare për ofruesit e shërbimeve. Sipas njoftimit, llogaritja e tarifave bazohet në kërkesën për të ardhura, vëllimin e ujit të shitur dhe efikasitetin në arkëtimin e të ardhurave, ndërsa kërkesa për të ardhura përfshin shpenzimet operative, mirëmbajtjen kapitale dhe kthimin në Bazën Rregullatore të Aseteve. Kompania ka theksuar se kërkesat për periudhën 2026-



2028 përfshijnë rritjen e shpenzimeve operative, veçanërisht për personelin dhe

energjinë elektrike, projekte kapitale për mirëmbajtjen e rrjetit dhe investime për

modernizimin e aseteve me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve.

## ADMINISTRATA E GJILANIT OFROI MBI 92 MIJË SHËRBIME GJATË VITIT 2025

**GJILAN, 5 DHJETOR** - Drejtoria e Administratës e komunës së Gjilanit ka mbyllur vitin 2025 me shumë punë të mira. Ushtruesja e detyrës e drejtorit, Arbenita Sopi-Haziri, ka thënë se në Kuvendin Komunal miratuan vendimin për largimin e gjobës për regjistrimin e mëvonshëm të lindjeve për të mundësuar regjistrimin pa gjobë të fëmijëve tanë të lindur jashtë vendit. Po ashtu, ka rikthyer në funksion e-kioskun e dytë për shërbime sa më afër qytetarit. “Transformuam hapësirat në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, vendosëm ashensorin



në objektin e Administratës dhe vendosëm sportelin për persona me nevoja të veçanta”, ka thënë Sopi-Haziri. U. d. e drejtorit të Administratës ka theksuar se në sektorin e

Gjendjes Civile janë ofruar mbi 92 mijë shërbime. Në Qendrën për Shërbim me Qytetarë janë pranuar mbi 100 mijë kërkesa. Derisa tregoi se kanë organizuar dëgjimet publike për: buxhetimin me pjesëmarrje, kornizën afatmesme buxhetore dhe buxhetin 2026. “Në korrik dhe gusht kemi punuar edhe të shtunave, me orar të zgjatur për mërgatën tonë. Falënderoj stafin e zyrtarëve për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe angazhimin e pandalshëm gjatë gjithë vitit në shërbim të qytetarëve”, ka pohuar drejtoresha Arbenita Sopi-Haziri.

## RAMOSAJ VENDOS T’I NDIHMOJË ME NGA 500 EURO PERSONAT ME SËMUNDJE MALINJE DHE ME 300 EURO LEHONAT

**Deçan, 5 janar** - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka njoftuar se ka marrë vendim t’i subvencionojnë me 500 euro të gjithë personat që përballen me sëmundje malinje. Vendimi tjetër i tij është për nënat lehona, të cilat do të subvencionohen me 300 euro për secilën lindje. “Do të subvencionojmë me 500 euro të gjithë personat që përballen me sëmundje malinje, si mbështetje morale dhe financiare në periudha të vështira. Do të subvencionojmë me 300 euro çdo nënë lehonë,



për secilën lindje, si shenjë përkrahjeje dhe respekti për sakrificën, mundin dhe rolin e tyre të pazëvendësueshëm në familje dhe shoqëri. Këto vendime janë dëshmi e fjalës së mbajtur dhe e përkushtimit tonë për politika sociale në shërbim të qytetarëve”, ka shkruar Ramosaj në “Facebook”.

## Faton Peci bëri homazhe në nderim të dëshmorit Xhevat Jusufi

**MITROVICË, 5 JANAR** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, ka bërë homazhe në nderim të jetës dhe veprës së intelektualit, veprimtarit dhe patriotit të shquar,

dëshmorit të kombit Xhevat Jusufi (05.08.1953-03.01.1999), me rastin e 27-vjetorit të rënies së tij. Duke nderuar figurën e Xhevat Jusufit, Peci theksoi se ai

ishte një nga personalitetet më të përkushtuar të çështjes kombëtare, shembull i guximit, sakrificës dhe i qëndrësës së palëkundur për liri, çlirim dhe shtetformim.

“Dëshmorët nuk vdesin kurrë - ata jetojnë përherë në shpirtin e kombit. Vrasësit e tyre qofshin të mallkuar përgjithmonë”, është shprehur Faton Peci.





# SHTRËNGOJE... “MADURO”, MOS LËSHO PE!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Inxhiniering i pamoralit:** Zgjedhjet e kurdisura midis padronit Kurthi dhe rrogëtares Osmani u mbajtën më 28 dhjetor 2025 në kohën më të papërshtatshme për opozitën dhe në kohën më të mirë për regjimin autokrat të Kurthit. Rezultatet e dëshmuar këtë. Kurthi për muaj të tërë përmes servilëve si Dehari, Haxhiu, Konjufca dhe pionëve të tjerë bleu kohë deri më 28 dhjetor. Presidentja në largim, e njohur si skajshmërisht e paskrupullt për pushtet gjatë tërë kohës, luajti sipas muzikës dhe nën urdhrat e Kurthit. Opozita impotente dhe thuaja klinikisht e vdekur nuk pati guxim ta refuzojë propozimin e rrogëtares së Kurthit për datën 28 dhjetor e që ishte gabim me fatalitet elektoral për të. Po të ishin mbajtur zgjedhjet në një datë tjetër, do të kishim rezultate tjera.

**Si e udhëhoqi Kurthi trukimin e rezultateve:** Askush nuk mund të më bind se Arian Tahiri i ka humbur zgjedhjet në Mitrovicën e “akademikut të kanalizimeve”. Peci është kryetar me vota të vjedhura dhe të blera nga Kurthi, dora vet! Policia dhe prokuroria nuk patën guxim t’i bëjnë hetimet deri në fund. Albin Kurthi, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, një javë para zgjedhjeve futi në keqpërdorim qindra miliona euro për më shumë se 150.000 pensionistë të moshës (që nuk kanë punuar as edhe një ditë të vetme e që marrin pensione, merreni me mend)!!, për më shumë se 50.000 studentë, mbi 100.000 mijë pensionistë kontributdhënës dhe mbi 250.000 familje me fëmijë duke ua ndarë nga 100 euro. I korruptoi për vota një trup votues thuaja prej 550.000 votuesve. Sipas të dhënave zyrtare në javën kur janë mbajtur zgjedhjet në Kosovë kanë hyrë 562.000 votues potencial. Qeveria e Kosovës përmes MPJD-së së kriminalizuar ka ndarë bileta

aeroplani, ka organizuar udhëtime me autobusë, ka paguar hotele gjatë qëndrimit në Kosovë dhe shpenzime tjera për një pjesë të mërgatës së korruptuar për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve që edhe e arriti. Rezervimet e biletave të aeroplanit bëheshin përmes sloganit: “Mërgata voton, fiton dhe feston”. Kapaciteti i LV-së nuk ka mjaftuar për këtë operacion aq të sofistikuar andaj dyshohet se kanë qenë të përfshira edhe segmentet tjera shtetërore. Një pjesë e mërgatës së korruptuar e ka dëmtuar rëndë të drejtën e votës dhe demokracisë. Është e papërgjegjshme që dikush që në Kosovë vjen një herë gjatë vitit apo më rrallë t’ua përcaktojë, me votën e korruptuar udhëheqjen apo mënyrën e qeverisjes qytetarëve me banim të përhershëm në Kosovë. Kjo pjesë e korruptuar e mërgatës fare nuk përballen me pasojat e votës së tyre. Ata kthehen në shtetin ku jetojnë ku nuk e kanë asnjë problem me cilat për çdo ditë përballen qytetarët e Kosovës si: mungesa e rrymës, e ujit, jetesa mbi plehra, shërbimet e këqija publike, shëndetësia jo që shëron por që shkurton jetë, analfabetizmin në arsim të Arbërie Nagavcit, pensionistë të shndërruar në lypsarë dhe gërryes të kontejnerëve, veteranë dhe invalidë të luftës që bëjnë vetëvrasje shkak i mjerimit material dhe shumë të tjera. Për më tepër këta mashtrues, përveç pensioneve të merituar që i marrin në shtetet ku jetojnë, përfitojnë edhe ndihma sociale sikur që e marrin, pa asnjë të drejtë morale dhe ligjore edhe pensionin e moshës në Kosovë. Albin Kurthi, falë korrupsionit dhe shpërdorimit të resurseve materiale dhe logjistike të shtetit dhe burimeve informale (Vuk Hamoviq, Martin Berishaj, GEN, dhe bizneset nga kontratat njëburimore) ka fituar mbi 50 për qind. Në dukje është një përqindje e lartë, për një shtet autokrat si ky i Kurthit ku, përveç disa gazetarëve të guximshëm, 100 për qind kontrollon qeverinë, mendermethënë presidencën, bordet dhe ndërmarrjet publike, policinë, AKI-në, gjykatat, gati edhe Prokurorinë, FSK-në dhe agjencionet e “pavarura” kjo është fitore e varfër, fitore e Pirros. Edhe Maduro kishte pushtet absolut, i fitonte

zgjedhjet duke ndarë vitra sociale si Kurthin, manipulonte duke korruptuar mërgatën (nga 22 milionë venezuelas, 7 milionë janë mërgatë) po ku është tani, nuk mund ta kalojë as pragun e nevojtores për t’u përshurrur! Jeta është e pamëshirshme, sidomos për mashtruesit dhe autokratët. Në Ballkan janë tre: Vuçiqi, Rama dhe Kurthi. Dodiku që më parë i vendoste k...t në tavolinë, pasi u trodh politikisht tash i veshë brekushet me sloganin MAGA (Make Amerika Great Again), si në kapelën e Trampit.

**OPOZITA:** 1. PDK-ja: ka mungesë lidërshipi karizmatik dhe të guximshëm që merr vendime, jo sa për ta ruajtur lëkurën dhe postin por që i krijon ardhmëri strategjike partisë. Lista e deputetëve ka pësuar ndryshime, mendoj pozitive por aty ka persona që me luftën dhe PDK-në kanë lidhje aq sa unë kam lidhje me Korenë e Veriut. PDK-ja është dashur që në seancën e parë ta votojë Lenka Haxhiun për kryetare të Kuvendit si dhe qeverinë e pakicës Kurthi 3. Po ta bënin këtë do ta kishin qeverinë në dorë. PDK-ja është dashur ta përkrahë propozimin e AAK-së për bërje të opozitarizmit duke ia kthyer pushtetit një sasi të vezëve, gazit dhe ujit. PDK-ja është dashur të organizojë protesta të natyrës sociale. PDK-ja është dashur ta votojë Glauk Konjufcën për KM pasi e ka votuar një antishqiptar (Bashën) për kryetar Kuvendi. PDK-na në asnjë mënyrë nuk është dashur ta pranojë datën 28 dhjetor (e imponuar nga autokrati Kurthi dhe rrogëtarja personale Osmani) për zgjedhje. PDK-ja duhet të lirohet nga disa arrogantë mujsharë që flasin në emër të partisë ndonëse nuk janë në strukturat e saj. PDK-ja duhet ta ruaj ADN-në kombëtare por jo duke promovuar analfabetë politikë që duan të mbijetojnë. Me këtë potencial që e ka dhe me një oportunizëm që po e ushqen që një kohë, PDK-ja nuk mund të rritet, ky është maksimumi i arritshëm. Me një rirreshtim, e vendosur për bërje të opozitarizmit aktiv dhe sakrifikues, me largimin apo marrje të fuqisë disa keqbërësve, PDK-ja shpejt do të rritet.

2. LDK-ja: Qartazi vuan nga “sindromi i Stokholmit”, dorëzohet dhe e dashuron dhunuesin e saj. Si do të kuptohej ndryshe dorëzimi

para Vjosa Osmanit që ua ndau partinë në dysh duke ia dorëzuar Albin Kurthit mbi 100.000 mijë vota si pajë elektorale. Në vend se t’ia shlyenin emrin me rrotë traktori, të dhunuarit e LDK-së ia siguruan kuorumin pikërisht dhunueses Osmani për t’u bërë presidente. Kur pa asnjë arsye e shkarkoi Valdete Dakën, si udhëheqëse e KQZ-së për ta zëvendësuar me pionin Radoniqi, LDK-ja nuk pranoi ta dërgojë lëndën në Gjykatë Kushtetuese. Nuk pranoi ta bëjë qeverinë e opozitës e as të bëhet pjesë e qeverisë Kurthi 3. Flirtimi i vazhdueshëm me Vjosa Osmanin dhe epizodik me Fatmir Limajn ndikoi keq te votuesi. Kurthi e futi në grackë duke e portretizuar si bllokues të formimit të institucioneve ndonëse 100 për qind bllokues ishte Kurthi. Lumi i Xhikës gaboi kur organet e Riinvestit deshi t’i veshë me brekë të LDK-së. Dhe, sikur edhe partitë tjera të opozitës, LDK-ja bëri gabim vdekjeprurës kur pranoi 28 dhjetorin si datë për mbajtje të zgjedhjeve.

3. AAK-ja: Bëri aq sa munda. Kam pritur të fitojë së paku 7 deputetë. E mira e AAK-së ishte se nuk refuzoi asnjë formë bashkëpunimi me opozitën. AAK-ja bëri gabim që i pranoi disa politikajë që u deklasuan nga partitë tjera duke e bërë riciklimin e dështimit.

**Si duhet të veprojë opozita:** Ndonëse LV-ja ka një epërsi të konsiderueshme, nëse opozita bashkohet dhe vendosë të zgjohet nga gjumi opozitar, ka shumë mundësi ta lë pa gjumë pozitën duke e detyruar të bëhet e përgjegjshme në qeverisje. Të mos bëhet arrogante dhe ta lirojë nga toksiciteti i tepërt. Kapaciteti intelektual dhe profesional i opozitës është shumëfish më i zoti. Për fat të mirë rrethanat do të imponojnë një opozitarizëm tjetër, më proaktiv dhe d o m o s d o s h m ë r i s h t bashkëpunues me qytetarë. Si pikënisje opozita duhet në mënyrë aktive të kundërshtojë rritjen jonormale të çmimeve të ujit, rrymës, artikujve të domosdoshëm për mbijetesë dhe të shërbimeve. Opozita duhet ta votojë buxhetin, marrëveshjet ndërkombëtare, Planin e Rritjes si dhe ligjet që janë të dobishme për Kosovën. Opozita nuk duhet në asnjë mënyrë të ngatërrohet në dy çështje: sigurimin e kuoromit për

presidentin/presidenten si dhe të bëhet pjesë e zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit. E para, personi më jounifikues dhe më pro LV-së e që, në të njëjtën kohë e ka dëmtuar opozitën e veçanërisht LDK-në është Vjosa Osmani. Pastaj, çdo kandidat i propozuar nga Kurthi është i besuari i Kurthit prandaj mos pranoni në asnjë mënyrë.

Marrëveshja e Brukselit me aneksin e Ohrit është pjellë e Borrellit, projugosllavit pasionant Surroi dhe mercenarit Weller. Të gjithë, përveç Kurthit po thonë se kjo është marrëveshja më e keqe për Kosovën prandaj opozita duhet të qëndrojë larg saj. Kurthi ka kërkuar pushtet absolut, e ka, le të merr përgjegjësi. Nëse bën punë të mira duhet të përkrahët nga të gjithë, unë do ta përkrah i pari. Isharetet nuk janë se do të bëjë punë të mira ku kemi dëshmi më të mirë se falja e tokave Manastirit të Deçanit; tetë vite demonizoi opozitën dhe udhëheqjen komunale në Deçan për këtë ndërsa vet, bashkë me analfabeten politike Donika Shvarc, brenda një nate ua siguroi popave të Deçanit fletën poseduese të pronave shoqërore këtij Manastiri. Kurthi është dinak, po e demonstroi një zbutje taktike për dy arsye: e para për ta fituar përkrahjen e opozitës për rizgjedhje të rrogëtares personale Osmani edhe për një mandat dhe, e dyta për ta bërë opozitën bashkëpjesëmarrëse në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit që Kosovën e shndërron në një federatë asimetrike .

Pas Maduros edhe “Maduro” ynë do t’i lëshojë brekët. Nuk ka dyshim a e zbaton Marrëveshjen e Brukselit - Ohrit por se në pyetje është si do të pakëtohet ky dorëzim dhe të shitet si sukses, si tokat e Manastirit të Deçanit. Për Kosovën do të ishte shumë keq nëse çështja e zbatimit do të shkonte në tryezën politike të Tramp si pjesë e menysë ku nuk do të na llogarisin as si supë pule. Nëse Kurthi e dërgon draftin e Zajebnicës në Gjykatën Kushtetuese, më nuk është në dorën tonë. Nëse nuk e dërgon, do të luaj pishpirik me Maduron në Amerikë, bashkë me Paf Diddy. Do të ketë shumë probleme dhe qëndrimi ndaj tyre Kurthin ose e bënë Hasan Prishtinë ose Rrahman Morinë. Të lutemi dhe të punojmë për të mirë!



# RRITJA E VAZHDUESHME E ÇMIMEVE, KËRKOHET NGA QEVERIA T'I VËZHGOJË BIZNESET

PRISHTINË, 5 JANAR - Kryetari i Shoqatës “Konsumatori”, Selatin Kaçaniku, ka thënë se qytetari konsumator nuk është njohur si sovran, taksapagues dhe faktor i rëndësishëm në vendimmarrje, por i diskriminuar dhe i anashkaluar. Krahas rritjes së çmimit në produktet esenciale, qytetarët kërkojnë edhe rritje të pagës. “Edhe viti 2025 ka qenë shumë i vështirë për arsye se ka pasur shumë lëvizje të çmimeve. Për fat të keq, shumica e çmimeve kanë lëvizur nga lart dhe fati edhe më i keq është se as kjo legjislaturë qeveritare nuk e ka njohur konsumatorin e Kosovës, nuk e ka njohur as si sovran, as si elektoral, as si konsumator, as si taksapagues

ligjërues të buxhetit të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto mosnjohje dëshmojnë se qytetari konsumator nuk është njohur dhe nuk i njihet e drejta demokratike e njeriut, as e njeriut qytetar konsumator dhe këto janë elemente shumë indinjuese dhe qytetari konsumator po ndihet shumë i shkelur, shumë i diskriminuar dhe i indinjuar”, ka thënë Kaçaniku në një intervistë për “Ekonomia Online”. Sipas tij, pandemia, luftërat dhe mungesa e kapaciteteve qeverisëse kanë ndikuar në rritjen e çmimeve dhe në mosbashkëpunim me shoqërinë civile. Ndërkaq qytetarët kërkojnë që rritja e çmimeve të shoqërohet



me rritje të pagave dhe pensione, ndërsa shprehin shqetësim për rritjen e energjisë elektrike dhe barrën që, sipas tyre, po bie mbi shtresat e varfra.

Qytetari Ilir Binaka kërkon më shumë reflektim dhe ndërhyrje nga qeveria për ta ndalur rritjen e çmimeve. Ai tregon raste të abuzimit, ku produktet shiten

më lirë për shkak se janë të skaduara, duke dëmtuar drejtpërdrejt konsumatorin. Ndërsa qytetari Izet Zhitia theksoi se kjo rritje po e ul mirëqenien familjare dhe çmimet mund të bien vetëm në kushte stabiliteti global. “Ne nuk mundemi me u nda prej botës, po e shihni se çka po bëhet, luftëra gjithandej. Çmimet janë të parat që reagojnë, edhe biznesi edhe njerëzit. Biznesi reagon duke i rritur çmimet, konsumatorët janë të pakënaqur, sepse rritja e çmimeve ia zvogëlon buxhetin, mirëqenien sociale në familjen e vet. Çmimet vetëm në situatën kur është qetësia botërore mund të ulen”, ka thënë Zhitia.

## LUKSEMBURGU NDAN MBI NJË MILION EURO PËR IDE INOVATIVE NË KOSOVË

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Pas suksesit të edicionit të parë, LuxDev ka lansuar edicionin e dytë të LuxAid Demonstration Fund (LDF) për mbështetje të zgjedhjeve inovative të bizneseve në Kosovë. Përmes thirrjes së re, LuxAid Demonstration Fund synon të bashkëfinancojë projekte biznesore inovative në dy fusha: inovacionin digjital dhe inovacionin e gjelbër. Përmes LuxAid Demonstration Fund, mbi një milion euro do të vihen në dispozicion dhe biznese të përzgjedhura do të përfitojnë bashkëfinancim deri në 350 000 euro për projektet e tyre, me qëllim zgjerimin e



aktivitetit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe krijimin e ndikimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror në Kosovë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është më 6 shkurt 2026. Thirrja do t'i mbështesë kompanitë, projektet ekzistuese

të cilave fokusohen në fusha si: intelijenca artificiale, analiza e të dhënave, automatizimi, fintech, e-commerce, siguria kibernetike, ofrimi i shërbimeve ICT të gatshme për eksport, zgjidhje inovative që ndërlidhin tranzicionin digjital dhe tranzicionin e gjelbër me punësimin si dhe zgjidhje HealthTech dhe e-shëndetësisë, me fokus të veçantë në kujdesin kardiovaskular. Po ashtu, do të mbështeten zgjidhje inovative që tashmë funksionojnë dhe kanë treg, të cilat synojnë kursimin e energjisë dhe kalimin drejt energjisë së pastër, zbatimin e

modeleve të ekonomisë qarkore dhe shfrytëzimin e mbetjeve, si dhe ofrimin e zgjidhjeve për përballjen me ndryshimet klimatike, veçanërisht në reduktimin e emetimeve të CO2 dhe në menaxhimin efikas të burimeve të tjera natyrore. Nga kjo mbështetje mund të përfitojnë kompanitë që janë të regjistruara në Kosovë para 1 nëntorit 2022, punësojnë të paktën pesë persona, kanë qarkullim nën 50 milionë euro dhe ofrojnë një produkt ose shërbim inovativ të testuar në treg, me të ardhura të dëshmuara për së paku një vit nga zgjidhja inovative.

Projektet duhet të kenë kohëzgjatje një deri në dy vjet dhe aplikantët duhet të jenë në gjendje të bashkëfinancojnë të paktën 50 % të shpenzimeve totale. Nga të gjitha aplikimet, dhjetë kandidatë që do të përzgjidhen në listën e ngushtë do të përfitojnë mentorim për realizimin e propozimit dhe përgatitjen e prezantimit përpara komisionit përzgjedhës. Prezantimet para komisionit përzgjedhës pritet të mbahen në qershor të vitit 2026, ndërsa vendimi final do të shpallet në korrik 2026, me përzgjedhjen e tre deri katër projekteve fituese.

## GUVERNATORI ISMAILI: LIGJET E DËRGUARA NË KUSHTETUESE PO E MBAJNË KOSOVËN JASHTË SEPA-s

PRISHTINË, 5 JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, në një intervistë për Agjencinë e Lajmeve “Ekonomia Online”, ka thënë se vonesat në shpalljen e tri ligjeve të kontestuara në Gjykatën Kushtetuese po pamundësojnë aplikimin për anëtarësim të Kosovës në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), duke i shkaktuar ekonomisë humbje



të konsiderueshme financiare. Sipas tij, vetëm nga kostot e larta të transfereve, bizneset dhe qytetarët e Kosovës po humbin rreth 55 milionë euro në vit. Ismaili ka theksuar se BQK-ja ka përmbushur të gjitha përgatitjet teknike dhe ligjore për aplikim, por procesi është bllokuar për arsye procedurale, duke e lënë Kosovën jashtë një sistemi që do ta ulte ndjeshëm

koston dhe kohën e pagesave me Bashkimin Evropian, partnerin kryesor tregtar të vendit. Po ashtu, Ismaili ka thënë se përgatitjet për anëtarësim në SEPA janë kryer në kohë rekord dhe me mbështetje të Bankës Botërore, ndërsa janë marrë edhe komente joformale nga Komisioni Evropian të cilat janë adresuar. Ai ka sqaruar se sapo ligjet të

shpallen, BQK-ja do të procedojë menjëherë aplikimin final, me pritshmëri që aprovimi të mund të vijë gjatë vitit 2026. Sipas guvernatorit, integrimi në SEPA nuk është vetëm çështje financiare, por një hap i drejtpërdrejtë drejt integritetit të sistemit financiar të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian, pa kaluar nëpër procesin politik të zgjerimit.

## Mbi 12 milionë vizitorë të huaj në Shqipëri në vitin 2025

TIRANË, 5 JANAR - Shqipëria ka shënuar një tjetër rekord në sektorin e turizmit gjatë vitit 2025, duke u vizituar nga mbi 12 milionë shtetas të huaj. Lajmin e ka dhënë ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, në rrjetet sociale, ku theksoi se shifra e këtij viti ka tejkaluar rezultatet e vitit paraprak.

Sipas Gonxhjas, ky zhvillim dëshmon rritjen e vazhdueshme të interesimit për Shqipërinë si destinacion turistik gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm në sezonin veror. Ai vlerësoi se diversiteti i ofertës turistike - nga turizmi kulturor, natyror e kulinar, deri tek ai sportiv - ka ndikuar drejtpërdrejt në këtë sukses.

“Me mbylljen e vitit 2025, Shqipëria thyen rekordin e një viti më parë, duke kapërcyer shifrën e 12 milionë vizitorëve me pasaportë të huaj! Një rezultat që konfirmon konsolidimin e vendit si një destinacion turistik gjithëvjetor, me interes të qëndrueshëm përtej sezonit veror dhe me

oferta të larmishme në turizëm kulturor, natyror, kulinar, sportiv dhe jo vetëm, duke forcuar pozicionin e saj në hartën ndërkombëtare të turizmi”, ka thënë ai. Autoritetet vlerësojnë se ky trend pozitiv e forcon më tej pozicionin e Shqipërisë në tregun ndërkombëtar të turizmit, duke e konsoliduar



vendin destinacion gjithnjë e më tërheqës për vizitorët e huaj.



# VENEZUELA BËHET SUPERARMA E NAFTËS, QË TRUMPI KA KUNDËR KINËS

Pekini është “humbësi më i madh” nga kapja e Nicolás Maduro-s



Ndërsa shumë liderë botërorë reagon me tronditje dhe hutim ndaj marrjes së kontrollit të Venezuelës nga Donald Trumpi, mesazhi i Kinës ishte i qartë: lironi Nicolás Maduron.

“Kina u bën thirrje Shteteve të Bashkuara të garantojnë sigurinë personale të presidentit Nicolás Maduro dhe bashkëshortes së tij, t’i lirojnë menjëherë dhe të ndalojnë përmbysjen e qeverisë së Venezuelës,” deklaroi të dielën Ministria e Jashtme e Kinës.

Kjo thirrje, që duket e kotë, nënvizon një të vërtetë të qartë mbi ndërhyrjen amerikane: ajo përbën një goditje të rëndë për Kinën. “Çfarëdo që të thotë Trumpi, ky aksion ushtarak nuk ka pasur pothuajse aspak lidhje me trafikun e drogës dhe ka pasur shumë të bëjë me Kinën,” thotë Ashley Kelty, drejtore kërkimesh në bankën e investimeve Panmure Liberum. “Në fakt, Kina është humbësja më e madhe nga e gjithë kjo.”

Kina ka derdhur miliarda dollarë në industrinë e naftës së Venezuelës, e cila është nën sanksione të rënda, duke përfutur në këmbim karburant me çmime të ulëta. Tregtarët raportojnë se nafta e destinuar për Kinën është shitur deri në 14 dollarë për fuçi më lirë se çmimi Brent, një zbritje e konsiderueshme kur çmimi referencë është rreth 60 dollarë për fuçi.

Veprimi i Trumpit jo vetëm që rrezikon t’i presë Kinës këtë burim të lirë furnizimi, por i ofron edhe SHBA-së një rrugë drejt dominimit energjetik që mund ta ndihmojë të rivalizojë Kinën në teknologjitë e së ardhmes, si intelijenca artificiale (IA).

Gjatë 20 viteve të fundit, Kina ka ushqyer forcën e vet industriale, rritjen ekonomike dhe ngritjen në skenën globale pjesërisht përmes zgjerimit të shpejtë të kapaciteteve të prodhimit të energjisë.

Në vitin 2024, Kina investoi 4,4% të PBB-së së saj në energji, krahasuar me 2% në SHBA. Sot, Kina konsumon ndjeshëm më shumë energji se SHBA-ja dhe ka kapacitet më të lartë prodhimi. Eliminimi i diferencës është bërë thelbësor, ndërsa SHBA-ja përpaket të ruajtë epërsinë në garën për IA. Kjo teknologji mbështetet në qendra të dhënash që konsumojnë sasi të mëdha energjie dhe në Silicon Valley ka shqetësime se mungesa e investimeve do t’i lërë kompanitë amerikane prapa në vitet që vijnë. OpenAI, zhvilluesi i ChatGPT, e ka përdorur drejtpërdrejt kërcënimin kinez për t’i bërë thirrje Uashingtonit të vendosë një objektiv kombëtar për energjinë.

“Në vitin 2024, Republika Popullore e Kinës shtoi 429 gigavat kapacitet të ri energjetik,

më shumë se një e treta e gjithë rrjetit amerikan dhe mbi gjysmën e rritjes globale të energjisë elektrike,” shkroi kompania në një letër të hapur vitin e kaluar. “SHBA-ja shtoi vetëm 51 gigavat, ose 12%.”

OpenAI i bëri thirrje qeverisë amerikane të vendosë një objektiv për ndërtimin e 100 gigavatëve kapacitet të ri në vit. Përveç kapacitetit, Kina ka disa prej kostove më të ulëta të energjisë në botë, pas investimeve masive në sektorin energjetik. Vetëm në vitin 2022, Pekini ofroi 2,2 trilionë dollarë subvencione për industrinë e karburanteve fosile, sipas FMN-së.

Tani Kina po përdor subvencione për të mbështetur industrinë e saj në zhvillim të IA. Qeveritë lokale po subvencionojnë faturat e energjisë për qendrat e të dhënave deri në 50%, raportoi Financial Times. Venezuela i jep SHBA-së një burim të gatshëm të naftës së rëndë, nga e cila varen rafineritë amerikane.

Vendi ka rezervat më të mëdha të provuara të naftës në botë, me rreth 303 miliardë fuçi nën tokë në vitin 2023, sipas Administratës Amerikane të Informacionit për Energjinë. Kjo përbën rreth 17% të rezervave globale.

Shumica e këtyre rezervave ndodhen në brezin e Orinokos, një zonë prej rreth 54 mijë

kilometrash katrorë përgjatë lumit Orinoko, ndërsa rezerva të konsiderueshme gjenden edhe nën Liqenin Marakaibo.

Megjithatë, pavarësisht pasurisë së madhe të naftës, prodhimi aktual i Venezuelës është i parëndësishëm në nivel global dhe popullsia jeton në varfëri. Prodhimi ra nga mbi 3 milionë fuçi në ditë në fillim të viteve 2000, në rreth 1 milion fuçi në ditë gjatë vitit të fundit.

Rënia e fortë ndodhi pasi ish-presidenti Hugo Chávez forcoi kontrollin mbi kompaninë shtetërore të naftës, PDVSA. “Sot Venezuela është në të njëjtin nivel me Libinë, Angolën dhe Kolumbinë, vende që përmenden rrallë në diskutimet mbi tregjet globale të naftës,” thotë Jeff Krimmel nga Krimmel Strategy Group. “Por ajo mund të ishte një nga lojtarët kryesorë.”

Trumpi shpreson ta përmbysë këtë rënie, duke i dhënë shtysë kompanive të mëdha amerikane të naftës dhe gazit. “Do të dërgojmë kompanitë tona gjigante të naftës, më të mëdhatë në botë, të investojnë miliarda dollarë, të rregullojnë infrastrukturën e shkatërruar dhe të fillojnë të krijojnë të ardhura për vendin,” tha ai të shtunën.

Venezuela shtetëzoi industrinë e naftës në vitin 1975, duke lënë kompanitë amerikane, përfshirë ato që sot janë ExxonMobil dhe

Chevron, me humbje të mëdha. Chevron është e vetmja kompani amerikane që operon ende në vend, por në shkallë shumë më të vogël dhe nën mbikëqyrje të fortë shtetërore.

Tani, shumë nga kompanitë që humbën në vitet ’70 mund të përfitojnë nga rihapja e vendburimeve gjigante të naftës. Në Wall Street, disa po shqyrtojnë tashmë mundësi investimi. Rreth 20 drejtues biznesi, përfshirë përfaqësues të fondeve kryesore spekulative, po përgatiten për një vizitë në Karakas në mars, për të vlerësuar investime në energji dhe infrastrukturë, sipas Wall Street Journal.

Ndërkohë, janë neutralizuar edhe kërcënime të tjera. Venezuela ka pretendime territoriale ndaj Guajanës, e cila kohët e fundit ka zbuluar rezerva të mëdha naftë. Një rritje e shpejtë e prodhimit, e udhëhequr nga Chevron dhe ExxonMobil, çoi në një rritje të PBB-së së Guajanës me 43,6% në vitin 2024.

Tani, me Trumpin në kontroll, kompanitë amerikane nuk kanë më arsye të shqetësohen. “Kina humbet akses në naftë të rëndë dhe ndikim në Amerikën Latine,” përfundon Kelty. “Dhe për SHBA-në, kjo është një fitore strategjike.”

Në fund të fundit, siç thoshte miku i vjetër i Trumpit, Henry



# RËNIA E NJË CAUDILLO-je



Nga shofer autobusi në lider sindikal, më pas deputet, ministër i Jashtëm dhe, pothuajse rastësisht, trashëgimtar i “komandantit të përjetshëm” të revolucionit bolivarian. Parabola e Nicolás Madurós përfundoi në një avion të forcave të armatosura amerikane, me këmishë të bardhë dhe pranga në duar, me vështrimin e mpirë të atij që e di se do të përballlet me një dënim dhe me shumë vite burg në një qeli amerikane. Prej muajsh Maduro e dinte se epilogu po afrohej. Në publik shfaqte siguri, kërcente salsa me bashkëshorten Cilia, dhe me një anglishte të çalë i dërgonte mesazhe paqeje Donald Trump-it: “Bëj paqe, jo luftë, Zoti Trump”.

Maduro nuk pati kurrë as forcën dhe as karizmën e Chávez-it, por u “pagëzua” prej liderit të madh në shtratin e vdekjes. U zgjodh në vend të Diosdado Cabello-s, Rasputinit të fuqishëm që drejton në hije forcat e armatosura dhe që tani duhet të vendosë: të pranojë dorëzimin dhe të udhëheqë tranzicionin drejt demokracisë, apo të hidhet

në një rezistencë të dëshpëruar kundër ushtrisë më të fortë të botës.

Pavarësisht emocionit popullor për vdekjen e Chávez-it, Maduro fitoi me diferencë minimale zgjedhjet presidenciale të vitit 2013. Për shumë drejtues të opozitës, duke nisur nga Maria Corina Machado, fitorja ishte fryt i manipulimeve, por kandidati humbës Henrique Capriles nuk pati guximin të përballej me regjimin.

Që prej asaj kohe, gjërat në Venezuelë ndryshuan rrënjësisht. Ushtria u bë gjithnjë e më e fuqishme; përveç agentëve kubanë të shërbimeve sekrete, më afër politikanit Maduro sesa ushtarakut të ashpër Cabello, u shtuan iranienët dhe rusët. Varësia ekonomike nga Kina u bë gjigante, aq sa edhe sot Karakasi i dërgon Pekinit më shumë se gjysmën e naftës së vet, për të shlyer një borxh prej 60 miliardë dollarësh.

Maduro u përpoq me çdo mënyrë të hynte në zemrën e popullit, por ishte një mision i pamundur përballë katastrofës së një qeverie të korruptuar dhe

të paaftë. E vetmja armë që i mbeti ishte represioni. Ai mashtroi dhjetëra të dërguar dhe vëzhgues të huaj, duke nisur nga diplomacia e pafuqishme e Brukselit, e cila sot, jo rastësisht, nuk ka pothuajse asnjë rol në zhvillimin e krizës.

Ndërsa shpallte programe të pabesueshme për rimëkëmbjen e ekonomisë, miliona venezuelianë braktisnin vendin: një e katërta e popullsisë emigroi, diaspora më e madhe e këtij shekulli, një dramë humanitare që tronditi edhe vendet fqinje, me Kolumbinë në krye.

Maduro vazhdoi të gënjente dhe t’u mbyllte gojën me forcë kundërshtarëve: të rinj të burgosur për protesta, radio dhe gazeta të mbyllura, parti politike të vëna nën administrim nga besnikë të regjimit.

Diktatura u konsolidua plotësisht me vjedhjen e madhe të zgjedhjeve të fundit presidenciale, ku u shpall një fitore që nuk ekzistonte, e bekuar nga aleatët rusë dhe kinezë.

Maria Corina Machado rezistoi për një vit e gjysmë në ilegalitet, më pas erdhi Çmimi Nobel për

Paqen, njëkohësisht me manovrat luftarake të Trump-it në Detin e Karaibeve. Dy presidentët folën menjëherë pas Krishtlindjeve; me shumë gjasë u vizatua akti final. Të lejonte kapjen mund t’i jetë dukur më dinjitoze sesa një dorëzim pa kushte. Tani u takon të tjerëve të zgjidhin çështjen e trashëgimisë.

Maduro do të përfundojë përpara të njëjtës gjykatë në Nju Jork që dënoi narcosin El Chapo Guzmán. Ai duhet të përgjigjet për pesë akuza dhe rrezikon deri në 40 vjet burg. Por nuk do të jetë ai që do ta vrasë chavizmin.

Fundin e ka shkruar Trumpi, i cili dje deklaroi se është gati të sulmojë sërish, madje edhe me më shumë forcë. SHBA duan të vendosin këmbën në Karakas për të vendosur qeverinë e ardhshme; Machado është, pa dyshim, e preferuara. Por jo menjëherë, siç del nga deklaratat e para të Trumpit.

Tranzicionin, që mund të jetë shumë i vështirë, nuk do ta menaxhojë trashëgimtar i Chávez-it, por linja e dytë e regjimit.

Nga njëra anë është krahua politik, i udhëhequr nga

zëvendëspresidentja Delcy Rodríguez dhe vëllai i saj Jorge, kryetar i Parlamentit; nga ana tjetër krahua ushtarak me Cabello-n. Ata përbëjnë sistemin mafioz të pushtetit që ka vënë dorë mbi ato pak pasuri strategjike të një vendi që zotëron rezervën më të madhe të naftës në botë, si edhe ar, diamante, kobalt dhe një pjesë të tregtisë së kokainës, e cila shkon kryesisht drejt Europës dhe Azisë.

Venezuelianët që kanë mbetur në vend mbyllen në shtëpi, blejnë rezerva ushqimore, askush nuk pret të kthehet në punë. Ndërsa miliona emigrantë kanë dalë në rrugë, nga Miami në Buenos Aires, duke kaluar nga Madridi, Roma dhe Bogota, për të festuar rënien e despotit me mustaqe. Kanë pritur 25 vjet. Tani janë gati të presin zhvillimet e ardhshme, duke shpresuar mbi të gjitha që të shmangen gjakderdhje të reja.

Për këtë arsye, shpresa është që Cabello të heqë dorë.

Janë derdhur shumë lot, janë ndarë shumë familje. Venezuela dëshiron të buzëqeshë sërish.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



Mirrored  
Security  
Paving



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82



## Bora forcohet me qendrën Thomas

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Klubi i Basketbollit Bora ka freskuar ekipin për vitin e ri, pasi ka sjellë në radhët e veta një basketbollist të huaj, që luan në pozitën e qendrës. Bëhet fjalë për amerikanin Lance

Thomas, i gjatë 208 centimetra, të cilin tashmë e ka paraqitur për pjesën e mbetur të këtij sezoni. Për amerikanin Thomas, Bora do të jetë përvoja e parë në Evropë pasi karrierë

kryesisht ka bërë në Meksikë, Venezuelë dhe Mongoli. Së fundmi, Thomas ishte pjesë e skuadrës Nairobi City Thunder dhe ka luajtur me një mesatare prej 14.5 pikëve, 6 kërcimeve dhe 3

asistimeve për ndeshje. Thomasi me fanellën e Borës pritet të debutojë këtë javë në kuadër të Kupës së Kosovës, ku ekipi nga kryeqyteti do të përballet me Rahovecin.



## KOMBËTARJA E KOSOVËS NË HENDBOLL LUAN DY MIQËSORE NË SLLOVENI

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Federata e Hendbollit e Kosovës ka nisur aktivitetet për vitin 2026, ndërsa Kombëtarja A e Kosovës në hendboll (meshkujt) do të zhvillojë dy ndeshje miqësore në Slloveni gjatë kësaj jave. Miqësoret janë planifikuar nga shtabi teknik, i udhëhequr nga selektori Jesper Ostlund, me synimin që ekipi kombëtar të

jetë sa më i përgatitur dhe i harmonizuar për ndeshjet e ardhshme garuese. Kombëtarja e Kosovës do të udhëtojë sonte (e martë) mbrëma drejt Laskos, ku edhe do të zhvillohet miqësorja e parë. Të enjten, më 8 janar, nga ora 17:00, Kosova do të përballet me Kuvajtin në Lasko. Ndërkohë miqësorja e dytë do



të luhet të shtunën, më 10 janar, nga ora 11:00, në Rogaska Slatina, ku Kombëtarja jonë do të ndeshet me Algjerinë. Për këto dy takime, selektori Ostlund pritet të ketë në dispozicion një numër më të madh lojtarësh, që do t'i mundësojë testimin e alternativave dhe rritjen e konkurrencës brenda skuadrës.

## MANCHESTER UNITEDI SHKARKON TRAJNERIN RUBEN AMORIM



**MANCHESTER, 5 JANAR** - Ruben Amorim më nuk është trajner i Manchester Unitedit, pasi ekipi anglez të hënën ka vendosur ta shkarkojë teknikun portugez. Shkarkimi i Amorimit vjen një ditë pas barazimit 1:1 të Manchester Unitedit në

udhëtim te Leeds Unitedi në kuadër të Premierë Ligës. Manchesteri këtë sezon nuk është në formën më të mirë në kampionat, pasi renditet në pozitën e gjashtë në tabelë me 31 pikë të mbledhura. "Me Manchester Unitedin që renditet në vendin e gjashtë në

Premierë Ligë, udhëheqja e klubit ka marrë vendimin se është koha e duhur për të bërë një ndryshim. Kjo do t'i japë ekipit mundësinë më të mirë për një përfundim sa më të lartë në Premierë Ligë. Klubi dëshiron ta falënderojë Rubenin për kontributin e tij

në klub dhe i uron gjithë të mirat në të ardhmen", ka njoftuar Manchester Unitedi. Amorim më 11 nëntor të vitit 2024 ishte emëruar trajner i Unitedit, ndërsa pas shkarkimit të tij ekipi do të udhëhiqet përkohësisht nga Darren Fletcher.

## TYSON FURY LË PAS PENSIONIMIT, DO TË RIKTHEHET NË RING KËTË VIT



**LONDËR, 5 JANAR** - Boksieri i peshave të rënda, Tyson Fury, ka njoftuar tifozët se ka vendosur të rikthehet nga pensionimi. Fury vendosi t'i varë "dorëzat" pas humbjes nga Oleksandr Usyk, por tani duket se ka ndryshuar mendje. Fury zyrtarisht ka konfirmuar se në vitin 2026 do ta shohim sërish në ring. "2026 është viti i rikthimit. Kam qenë jashtë për një kohë, por jam kthyer tani, 37 vjeç dhe po godas ende. Nuk ka asgjë më të mirë se t'i godasësh disa

burra në fytyrë dhe të paguhesh", ka shkruar ai në "Instagram". Fury nuk ka zhvilluar asnjë meç që nga humbja e tij e dytë radhazi me pikë ndaj Oleksandr Usykut në Riad në dhjetor të vitit 2024, një duel pas të cilit ai u ankua për atë që e konsideroi rezultat të padrejtë dhe tri javë më vonë njoftoi tërheqjen nga boksi. Fury pritej gjerësisht që të rikthehej nga pensionimi dhe më në fund të merrte pjesë në përballjen e shumëpritur dhe shumë fitimprurëse mes

dy britanikëve me rivalin e tij të madh, Anthony Joshua, në muajt gusht ose shtator, potencialisht në Londër, si ndeshja kryesore e Riyadh Season, me një meç parapërgatitor që pritej të zhvillohej më herët gjatë vitit në Arabinë Saudite. Megjithatë, mbetet e paqartë se kush do të jetë kundërshtari i radhës i Furyt, teksa Usyku ndodhet aktualisht në negociata për një përballje të madhe me ish-kampionin e gjatë të WBC-së, Deontay Wilder.

## Interi rikthen Asllanin? Lëvizje e mundshme në janar

**TORINO, 5 JANAR** - Mesfushori shqiptar Kristjan Asllani mund të rikthehet tek Interi me efekt të menjëhershëm,

sipas raportimeve të gazetarit të njohur Fabrizio Romano. Asllani nuk konsiderohet më lojtar kyç te Torino, e plani i klubit

është që ai të gjejë një huazim të ri gjatë janarit për të siguruar më shumë minuta loje. Vendimi përfundimtar pritet të

merret së shpejti, ndërsa tifozët e Interit mbeten të vëmendshëm për mundësinë e rikthimit të mesfushorit në skuadër.







**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 31.12.2025 bënë shpallje publike për dhënien e pronës së paluajtshme me qira.

## Shpallje Publike

### T-25-11

|                             |                                                                                                             |
|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kriteret e Dhënies:         | Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë                                                      |
| Data e shpalljes:           | 31.12.2025                                                                                                  |
| Sqarimi:                    | deri me 15.01.2026                                                                                          |
| Kërkesa për pjesëmarrje:    | Data(t) për kërkesës deri: 15.01.2026<br>Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë. |
| Dorëzimi i ofertave:        | Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)<br>(Origjinali dhe Kopja)                       |
| Afati i fundit i dorëzimit: | 15.01.2026 në 11:00                                                                                         |
| Vendi i dorëzimit:          | Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.                                                                   |

Për më shumë detaje lidhur me këtë shpallje, ju lutemi vizitoni [www.trepcasha.com](http://www.trepcasha.com) ose na kontaktoni në adresat e mëposhtme.

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

|                                                          |                            |                                                                           |
|----------------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------|
| Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>                        |                            |                                                                           |
| Adresa postare: <i>Parku industrial, Mitrovicë 40000</i> |                            |                                                                           |
| Qyteti: <i>Mitrovicë</i>                                 | Kodi postarë: <i>40000</i> | Shteti: <i>Republika e Kosovës</i>                                        |
| Kontakti: <i>sales@trepcasha.com</i>                     |                            | Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i><br>Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i> |
| <i>www.trepcasha.com</i>                                 |                            |                                                                           |



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “07 Green” Shpk, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për sistemin solar fotovoltaiik me kapacitet 1.7 MW në Jabllanicë, Gjakovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Jabllanicë të Gjakovës, do të organizohet debat publik nga “07 Green” Shpk, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “07 Green” Shpk, Gjakovë, për Pëlqim Mjedisor, për sistemin solar fotovoltaiik me kapacitet 1.7 MW në Jabllanicë, Gjakovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

[vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Gashi” Shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për ekspolatimin e materialeve inerte, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.02.2026 në ora 10:00 në Qendra për Karrierë IAAP “Rifat Gjota” Pejë, do të organizohet debat publik nga “Gashi” Shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Gashi” Shpk, Pejë, për ekspolatimin e materialeve inerte, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

[vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Eco Kos” L.L.C. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/6477/MMPHI/521/DMM për veprimtarinë: Impiant-depo për mbledhje, grumbullim, magazinim, dhe trajtim fizik të vajrave dhe yndyrave ushqimore, Milloshevë, Obiliq , organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 14.01.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Eco KosL.L.C, rruga e Llapit, numër 10, Milloshevë, Obiliq, do të organizohet debat publik nga operatori “Eco Kos” L.L.C. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/6477/MMPHI/521/DMM për veprimtarinë: Impiant- depo për mbledhje, grumbullim, magazinim, dhe trajtim fizik të vajrave dhe yndyrave ushqimore, Milloshevë, Obiliq,në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

Zoom Meeting invitation - Debat Publik - Eco Kos L.L.C

10:00 - 11:00

Wed, 14 Jan 2026

Meeting ID: 601 399 3690

Passcode: fPrr0s

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=ECO>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

“Eco Kos” L.L.C.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “KPSEG” L.L.C. me seli në Podujevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812004670 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “KPSEG” D.O.O. od Podujeva, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812004670 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “KPSEG” L.L.C. with headquarters Podujeva, has come to the decision to quit its business: 812004670 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.